

VENDIM
Nr. 580, datë 8.10.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 598, DATË 1.7.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE
TË PROCEDURAVE PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDISIN
NDËRKUFITAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 598, datë 1.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kreu I ndryshohet, si më poshtë vijon:

“I. PROCEDURA PARAPRAKE DHE NJOFTIMI I ZHVILLUESIT”

1. Zhvilluesi, që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, që në fazat fillestare të planifikimit të projektit/projektidesë, paraqet nëpërmjet sistemit elektronik pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin kërkesën dhe dokumentacionin e parashikuar në kërret I dhe II, të vendimit nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas marrjes së aplikimit nga ministria, ndjek procedurën e përcaktuar në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, dhe vlerëson nëse projekti i propozuar është i listuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe nëse mund të ketë efekte të rëndësishme në mjedisin e një apo më shumë shteteve fqinje, bazuar në identifikimin e ndikimeve ndërkufitare, sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Kur plotësohen kushtet e pikës 2, të këtij kreu, Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton zhvilluesin se projekti i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) në kontekst ndërkufitar dhe i kërkon të plotësojë formatin e njoftimit të shtetit fqinj dhe dokumentacionin e kërkuar në të, bazuar në shtojcën 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Formatin dhe dokumentacionin, të përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu, dorëzohen në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, dhe procedura e vlerësimit bëhet sipas parashikimeve të këtij vendimi.”.

2. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së formatit të njoftimit dhe dokumentacionit shoqërues, përcjell praktikën për mendim/konsultim në lidhje me çështjet që kërkojnë të merren parasysh në raportin e VNM-së, duke theksuar edhe afatin prej 20 (njëzet) ditësh punë për dërgimin e mendimit të tyre tek institucionet e mëposhtme:

- a) Ministrinë e linjës, në varësi të projektit;
- b) Drejtorinë teknike të ministrisë, sipas specifikave të projektit;
- c) Institucionet e tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore e civile;

c) Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

d) Njësia e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti.”.

b) Në fund të pikës 7 shtohen fjalët “..., dhe ministria këto të dhëna ia përcjell Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.”;

c) Në pikën 8, pas fjalëve “... gjykohet e nevojshme ...” shtohen “... nga AKM-ja ...”;

ç) Në pikën 10, fjala “Ministria” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia Kombëtare e Mjedisit”.

3. Në kreun III bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e dorëzimit të raportit të VNM-së nga ana e zhvilluesit, dërgon një kopje të tij për mendim/konsultim, së bashku me përmbledhjen joteknike të këtij raporti, duke theksuar afatin prej 20 (njëzet) ditësh punë për dërgimin e mendimit të tyre, tek institucionet e mëposhtme:

a) Ministrinë e linjës, në varësi të projektit;

b) Drejtorinë teknike të ministrisë, sipas specifikave të projektit;

c) Institucionet e tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;

ç) Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

d) Njësia e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti.”.

b) Në pikat 4, 5, 7 dhe 8, fjala “Ministria” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia Kombëtare e Mjedisit”;

c) Në fund të fjalisë së dytë, të pikës 6, shtohen fjalët “... dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.”.

II. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama